



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Dokument Parlamentar

RAPORT

**PËR PROPOZIMIN E SHKARKIMIT TË ZOTIT ARBEN MALAJ
NGA DETYRA E ANËTARIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS
TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjen e datës 16.12.2019, zhvilloi seancën dëgjimore dhe mori në shqyrtim arsyetimin dhe propozimin për shkarkimin e zotit Arben Malaj nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Vendimit nr. 766, datë 3.12.2019, në të cilin ka vendosur pezullimin nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Komisioni, bazuar në nenin 115 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi çështjen në përputhje me rendin e ditës dhe kalendarin e punimeve të tij.

Komisioni konstatoi se:

Me shkresën nr. 2790 të datës 15.07.2018, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste ka depozituar në Kuvend propozimin për shkarkimin e Zotit Arben Malaj si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Me shkresën nr. 2791/1, të datës 16.07.2019, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, i ka përcjellë për kompetencë Këshillit të Ministrave, trajtimin e propozimit, sipas autorizimit propozimin e nënshkruar nga 28 deputetë për shkarkimin e Z. Arben Malaj si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Me Vendimin nr. 766, datë 3.12.2019, Këshilli i Ministrave me propozim të Kryeministrit, ka vendosur pezullimin nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë duke kërkuar shkarkimin e Zotit Arben Malaj. Ky Vendim i është përcjellë Kuvendit për vendimmarrje të mëtejshme.

Neni 115 i Rregullores së e Kuvendit (Shkarkimi i anëtarëve të organeve të krijuara me ligj) parashikon që:

- 1. Kërkesa për shkarkimin e anëtarëve të organeve të krijuara me ligj i paraqitet Kryetarit të Kuvendit me shkrim dhe në mënyrë të motivuar e konkrete për shkaqet e parashikuara në ligj.*
- 2. Kryetari i Kuvendit ia përcjell kërkesën, së bashku me dokumentacionin shoqërues, komisionit të përhershëm përkatës, i cili duhet të paraqesë një raport për seancën plenare brenda 4 javëve nga data e marrjes së kërkesës.*

3. Shqyrtimi i çështjes në komision kryhet nëpërmjet një procedure që i garanton personit, që kërkohet të shkarkohet, të drejtën për t'u informuar në kohë, për t'u pyetur, për t'u dëgjuar dhe për të bërë pyetje ndaj kërkuesve të shkarkimit dhe për të paraqitur shpjegimet e tij.

4. Konferenca e Kryetarëve përcakton datën e votimit në Kuvend të kërkesës për shkarkim dhe, në rast se kërkohet nga një kryetar grupi parlamentar, edhe kohën e debatit, sipas nenit 48 të kësaj Rregulloreje, e cila në çdo rast duhet të jetë jo më vonë se 3 javë nga paraqitja e raportit të komisionit. Në rast se kërkohet nga vetë personi, nga 7 deputetë ose nga kryetari i një grupi parlamentar, personit, ndaj të cilit kërkohet shkarkimi, i jepet fjala në seancë plenare jo më shumë se 15 minuta.

Në referim të dispozitës së mësipërme, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, konstaton se janë respektuar të gjitha dispozitat procedurale për sa i takon paragrafit 1 dhe 2 të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë është organ i krijuar dhe rregulluar nga Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë". Këshilli Mbikëqyrës i bankës së Shqipërisë është organ që përmendet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, por organizimi i këtij Këshilli nuk trajtohet nga dispozitat Kushtetuese dhe nuk rregullohet prej tyre, në ndryshim nga Guvernatori, emërimi i të cilit parashikohet me dispozita të posaçme nga Kushtetua.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në zbatim të paragrafit 3 të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit, ka njoftuar në kohë Zotin Arben Malaj për mbledhjen e Komisionit, e ka njoftuar atë për të marrë pjesë, për t'u pyetur, dëgjuar dhe informuar për arsyet e kërkuesve të nisjes së procedurave të shkarkimit ndaj tij.

Konferenca e Kryetarëve, në respektim të paragrafit 4 të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit dhe afatit të parashikuara nga ligji "Për Bankën e Shqipërisë", ka përcaktuar datën e votimit në Kuvend të kërkesës për shkarkim.

Zotit ARBEN Malaj në respektim të të drejtave të eta për t'u njohur dhe konsultuar me aktet i janë vë në dispozicion paraprakisht i gjithë dokumentacioni që i është përcjellë edhe Komisionit të Ekonomisë dhe deputetëve.

Zoti Arben Malaj, në ushtrim të të drejtave të tij të parashikuara nga paragrafi 4 i nenit 115 të Rregullores së Kuvendit, në datë 6.12.2019, ka depozituar në Kuvend kërkesën për të drejtën e fjalës në seancë plenare.

Mbledhja e Komisionit u hap nga Kryetari i Komisionit zoti Arben Ahmetaj, i cili ish edhe relatori i çështjes. Zoti Arben Ahmetaj i përshkroi deputetëve procedurën dhe dispozitat ligjore mbi të cilat mbështetej procedura e shkarkimit si dhe dispozitat e konsideruar si të shkelura nga zoti Arben Malaj.

Pas kësaj ju dha fjala zotit Arben Malaj, i cili pasi prezantoi qëndrimin e tij, ju përgjigj pyetjeve të deputetëve. Për diskutimet e zhvilluara në mbledhjen e Komisionit, referimi i plotë gjendet në proces-verbalin e mbledhjes së Komisionit të Ekonomisë të datës 16 Dhjetor 2019.

Në lidhje me rastin, anëtarëve të Komisionit i ish shpërndarë paraprakisht:

- Vendimi Këshillit të Ministrave, relacioni shoqërues i Vendimit nr. 766, datë 3.12.2019, me të cilin Këshilli i Ministrave me propozim të Kryeministrit, ka vendosur pezullimin nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë duke kërkuar shkarkimin e zotit Arben Malaj;

- Shkresa nr. 2790 të datës 15.07.2018, me të cilën Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste ka depozituar në Kuvend propozimin për shkarkimin e Zotit Arben Malaj si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;

- Shkresa nr. 2791/1, të datës 16.07.2019, me të cilën Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, i ka përcjellë për kompetencë Këshillit të Ministrave, trajtimin e propozimit, sipas autorizimit propozimin e nënshkruar nga 28 deputetë për shkarkimin e Z. Arben Malaj si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Për sa trajtohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave dhe referuar kërkesës për shkarkim, duhen konsideruar dispozitat si më poshtë vijon:

Ligji “Për Bankën e Shqipërisë” (Neni 47)

1. Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, duke përfshirë guvernatorin dhe zëvendësguvernatorët pezullohet nga detyra nga Këshilli i Ministrave dhe shkarkohet nga Kuvendi, në qoftë se ai ose ajo:

d) gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë aktive merr pjesë në veprimtari politike.

2. Guvernatori dhe zëvendësguvernatorët e Bankës së Shqipërisë, si dhe çdo anëtar tjetër i Këshillit Mbikëqyrës, mund të shkarkohen nga Kuvendi me propozim të shumicës së gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, kur:

c) personi i propozuar për shkarkim gjatë ushtrimit të detyrës ka shkelur rëndë etikën e punës dhe ka cenuar thellë interesat e Bankës së Shqipërisë.

3. Në rast se anëtari i Këshillit Mbikëqyrës, duke përfshirë guvernatorin dhe zëvendësguvernatorët, është pezulluar prej detyrës nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi nuk e ka shkarkuar brenda 30 ditëve nga pezullimi, atëherë ky pezullim shfuqizohet dhe anëtari i pezulluar rifiton të drejtat dhe detyrimet menjëherë.

1. Rregullimi i parashikuar nga Vendimi i Kuvendit nr.134/2018.

Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 134/2018 të datës 20.12.2018 ka miratuar MANUALIN E MONITORIMIT VJETOR DHE PERIODIK pjesë e të cilit janë rregullat për sjelljen publike të personave të emëruara nga Kuvendi, midis të tjerave parashikon:

“Institucionet në monitorim, që nuk janë pjesë e sistemit të drejtësisë, miratojnë Kodin Etik dhe Rregullat e Sjelljes, të cilat duhet të mbajnë në konsideratë dhe të rregullojnë midis të tjerave etikën e funksionarit publik të emëruar nga Kuvendi dhe normat e përfaqësimit të institucionit prej tyre tek të tretët dhe ndaj publikut. Për çdo individ që merr një emërim nga Kuvendi, duhet të jetë e qartë, që me vullnet të lirë po merr përsipër një funksion publik. Ndaj pas këtaj, e gjithë sjellja dhe veprimtaria e tij duhet të ridimensionohet, duke u përshtatur me funksionin publik dhe me qëllim që të sigurohet dhe të mos çenohet paanësia në ushtrimin e funksionit individual nga njëra anë dhe funksionit të institucionit nga ana tjetër.”

Në analizë të dispozitave të nenit 47 të Ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” dhe normave të parashikuara nga vendimin nr. 134/2018 të datës 20.12.2018 (“Manuali i Monitorimit Vjetor dhe Periodik të Institucioneve”),

Rezulton që gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim, Zoti Arben Malaj, i emëruar nga Kuvendi si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, ka pasur si sjellje konstante personale, daljet publike dhe deklamim të qëndrimeve personale të natyrës politike, të palidhura me politika mbikëqyrje të Bankës së Shqipërisë dhe që nuk gjejnë asnjë referim në çështje të diskutuara në

veprimtari të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë, apo që të mund të klasifikohen si veprimtari në shërbim të edukimit të publikut, mbi tregun bankar.

2. Rregullimi i parashikuar nga Kodi Etik i Këshillit Mbikëqyrës të BSH i vitit 2003.

Për referimin e rastit, rezulton se Këshilli Mbikëqyrës i BSH ka miratuara Rregulla të posaçme për sjelljen publike të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të BSH.

Rregullimi i sjelljes publike të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë është trajtuar denjësisht në “Kodin e Etikës”, të miratuar nga ky Këshill që në vitin 2003.

Si pjesë e atyre rregullave parashikohet që:

“Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të marrin parasysh karakterin publik të funksionit të tyre dhe të sillen në mënyrë të tillë që të ruajnë dhe të nxisin besimin në publik lidhur me ta. Ata duhet të jenë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e detyrave dhe të përgjegjësive të tyre, pasi përfaqësojnë organin më të lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të veprojnë në interesin më të mirë të përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë, si dhe të gjithë sistemit bankar në Shqipëri.

Në përputhje me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, kur ushtrojnë pushtetet dhe kryejnë detyrat që u janë ngarkuar, nuk duhet të kërkojnë ose të marrin udhëzime nga institucione apo nga organizma të tjerë jashtë Bankës së Shqipërisë. Ata, gjithashtu, nuk duhet të ndikohen nga çdo subjekt tjetër që kërkon të influencojë tek ata për të ndërhyrë në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë.

Çdo veprimtari tjetër e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, e cila kryhet jashtë detyrave të tij të përcaktuara në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” nuk duhet të ketë ndikim negativ mbi detyrimet që ai ka ndaj Bankës së Shqipërisë dhe nuk duhet të dëmtojë imazhin e saj. Në artikujt shkencorë ose akademikë, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të qartësojnë se artikulli është hartuar personalisht dhe nuk përfaqëson qëndrimin zyrtar të Këshillit Mbikëqyrës apo të Bankës së Shqipërisë.

Marrëdhëniet e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës me grupe që përfaqësojnë interesa të tjerë, nuk duhet të bien ndesh me pavarësinë dhe me integritetin që kërkon pozicioni i tyre në Bankën e Shqipërisë.”

Parashikimet e Kodit Etik të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë janë në të njëjtën linjë arsyetimi dhe rregullimi me sa kërkohet edhe nga Manuali i Monitorimit Vjetor dhe Periodik i miratuar me Vendim të Kuvendit.

3. Kërkesa për Këshillin Mbikëqyrës të BSH, miratuar me rezolutën e Kuvendit të datës 8.5.2019.

Në vijim të trajtimit të këtij shqetësimi, Kuvendi në REZOLUTË 8.5.2019 PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2018, midis të tjerave ka kërkuar që: “Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë të marrë në shqyrtim zbatimin e Kodit të Etikës nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, për të standardizuar rregullat e sjelljes dhe përfaqësimit publik të institucionit, në përputhje edhe me dispozitat e miratuara nga Kuvendi në lidhje me Manualin e Monitorimit Vjetor dhe Periodik, për pjesën që i takon kësaj çështjeje.”

Në vlerësim të sjelljes në raport me publikun të Zotit Arben Malaj, konstatohet se Zoti Malaj në cilësinë e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, në asnjë nga daljet e veta nuk ka trajtuar asnjë nga çështjet që mund t’i shërbejnë publikut për edukimin e tij ose për informimin e publikut për

veprimtari të Këshillit Mbikëqyrës në kufijtë e lejuar nga legjislacioni i fushës.

TEMAT e trajtuara prej tij në të gjitha daljet publike kanë qenë të natyrës thellësisht politike, të palidhura, të ndryshme dhe në konflikt me politikat e rregulluara dhe mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë.

Si të tilla ato vijnë në kundërshtim të hapur me fushën e kompetencave të ushtruara si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, kompetencat e të cilit parashikohen në Nenin 43 i Ligjit “Për bankën e Shqipërisë”.

4. Analiza e dispozitave ligjore për marrjen e masave institucionale ndaj rastit.

Në analizë të dispozitave të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” dhe të akteve të miratuara nga Kuvendi mund të arsyetojmë:

Zoti Arben Malaj është një nga anëtarët e emëruar në këtë post më vendim të Kuvendit në mbështetje të nenin 44 të Ligjit organik të Bankës së Shqipërisë.

Neni 47 i Ligjit parashikon se:

2. Guvernatori dhe zëvendësguvernatorët e Bankës së Shqipërisë, si dhe çdo anëtar tjetër i Këshillit Mbikëqyrës, mund të shkarkohen nga Kuvendi me propozim të shumicës së anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, kur:

c) personi i propozuar për shkarkim gjatë ushtrimit të detyrës ka shkelur rëndë etikën e punës dhe ka cenuar thellë interesat e Bankës së Shqipërisë.

d) gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë aktive merr pjesë në veprimtari politike.

Zoti Malaj rezulton se ka shkelur haptazi, jo një, por dy nga kufizimet e parashikuara nga neni 47 i Ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”.

Duhet të jetë e qartë që nisma nuk ka për qëllim pengimin e veprimtarisë politike të Zotit Arben Malaj. Nisma mbështetet në dispozita që parashikojnë papajtueshmërinë e ushtrimit të funksionit publik (në rastin konkret detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të bankës së Shqipërisë), me deklarin e qëndrimeve të karakterit politik.

Nisma nuk çënon lirinë e individit Arben Malaj që ai të deklarohej si aktor, ose faktor politik, por synon respektimin e ndalimeve që Ligji “Për Bankën e Shqipërisë” parashikon për rastet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Këto ndalime, nuk kanë hyrë në fuqi pas aktit me të cilin Kuvendi ka emëruar në atë detyrë zotin Malaj. Ato kanë qenë në fuqi kohë më parë, ndaj si të tilla respektimi i tyre i ngarkojë Zotit Malaj njëkohësisht dhe së bashku me detyrimet e tjera të lidhura me funksionin për të cilin kandidoi dhe të cilin ka marrë përsipër të kryejë.

Duke konsideruar këtë dispozitë, dhe Rezolutën e miratuar për vlerësimin e veprimtarisë për vitin 2018, duhet vlerësuar që Kuvendi në rezolutë i ka kërkuar Këshillit Mbikëqyrës dhe si rrjedhim anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të BSH që të analizojnë aktet e miratuara nga vetë Këshilli Mbikëqyrës dhe të shprehen në lidhje me vendimmarrjen në këshill ose individualisht.

Në vijim Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në datën 16 Korrik 2019, ka dalë më një deklaratë si vijon:

“Si institucion i pavarur kushtetues, Banka e Shqipërisë i shërben interesit publik dhe konsideron llogaridhënie dhe transparencë në themel të mirëqeverisjes së institucionit. Respektimi i këtyre parimeve nga anëtarët e organeve të saj drejtuese dhe nga punonjësit është jetësor për sigurimin e besueshmërisë së publikut, medias dhe organeve legjislative dhe ekzekutive të Republikës së Shqipërisë ndaj institucionit. Mbështetur mbi këto standarde dhe në harmoni të

plotë me frymën e Kodit të Sjelljes për Zyrtarët e Lartë të Bankës Qendrore Evropiane, Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar, në qershor 2003, Kodin e Etikës së Bankës së Shqipërisë, i cili përcakton rregullat e integritetit dhe të sjelljes që duhet të zbatohen nga anëtarët e organeve drejtuese dhe punonjësit e Bankës së Shqipërisë. Kodi i Etikës reflekton praktikën më të mira në fushën e bankingut qendror, duke njohur, njëkohësisht, karakteristikat e veçanta institucionale të Bankës së Shqipërisë dhe pavarësinë politike të saj. Në përcaktimin e parimeve bazë të sjelljes së anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, Kodi i Etikës sanksionon detyrimin e tyre për të qenë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e detyrave dhe të përgjegjësi të tyre, pasi përfaqësojnë organin më të lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të veprojnë në interesin më të mirë të Bankës së Shqipërisë, si dhe të sistemit bankar në Shqipëri (pika 1.3). Në këtë kuadër, Kodi i Etikës përcakton shprehimisht se çdo veprimtari tjetër e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, e cila kryhet jashtë detyrave të tij të përcaktuara në Ligjin për Bankën e Shqipërisë, nuk duhet të ketë ndikim negativ mbi detyrimet që ai ka ndaj Bankës së Shqipërisë dhe nuk duhet të dëmtojë imazhin e saj (pika 2.3). Kodi i Etikës parashikon vetëm një rast kur anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës i lejohet të ndajë qëndrimet e veta nga ato të Bankës së Shqipërisë. Në publikimin e artikujve shkencorë, apo akademikë, anëtari mund të qartësojë se artikulli mund të mos përfaqësojë qëndrimin zyrtar të Këshillit Mbikëqyrës apo të Bankës së Shqipërisë (pika 2.3). Mbështetur mbi sa më sipër, Banka e Shqipërisë u ka bërë të ditur, në vazhdimësi, të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës detyrimin për të mbajtur parasysh se, që nga momenti i emërimit, deri në përfundim të mandatit, ata përfaqësojnë, në çdo situatë, organin më të lartë drejtues të institucionit dhe se me deklaratimet apo veprimet e tyre mund të dëmtojë imazhin e tij. Ky qëndrim institucional është në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, të cilat u kërkojnë zyrtarëve publikë të kujdesen që gjatë përfshirjes në debate politike apo publike, të mos dëmtojnë besimin e publikut në aftësinë e tyre për t'i përmbushur detyrat me paanësi dhe besnikëri. Mbi këtë bazë, Banka e Shqipërisë shprehet e vendosur në qëndrimin e vet se, gjatë ushtrimit të detyrave, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të respektojnë kufizimet e Kodit të Etikës mbi veprimtarinë e tyre politike dhe publike, të vendosura ligjërisht dhe për shkak të natyrës së veçantë të pozicionit dhe funksionit të tyre. Çdo qëndrim individual që bie ndesh me karakterin publik të rolit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe detyrimin e tyre për të promovuar besimin publik në integritetin, paanësinë dhe efektivitetin e Këshillit Mbikëqyrës, duhet detyrimisht të trajtohet si jo përfaqësues i institucionit dhe në kundërshtim me rregullat e Kodit të Etikës.”

Sa më sipër kjo deklaratë zyrtare e Bankës së Shqipërisë, mbështet arsyetimin dhe interpretimin e bërë për rastin si nga deputetët që kanë nënshkruar kërkesën për shkarkim, ashtu edhe motivin ligjor që ka shtyrë Këshillin e Ministrave që të vendosë pezullimin nga detyra për zotin Arben Malaj.

Vlerësimi i sjelljes publike të zotit Arben MALAJ

Nëse analizon secilën prej daljeve publike të Zotit Arben Malaj dhe të gjitha ato të marra së bashku mund të arrihet në konkluzionin se:

Në asnjërin prej rasteve të daljeve publike të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, ato dalje nuk i kanë shërbyer të interesit më të mirë të përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë, si dhe të gjithë sistemit bankar në Shqipëri;

Në asnjërin prej rasteve të daljeve publike të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës nuk është marrë parasysh karakter publik i funksionit që ushtron si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të BSH dhe

kjo natyrë sjellje nuk ka qenë dhe nuk i ka shërbyer aspak ruajtjes dhe nxitjes së besimit në publik lidhur me institucionin e Bankës së Shqipërisë;

Në asnjërin prej rasteve të daljeve publike të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës nuk reflektohet përgjegjësi institucionale në raport me temat e trajtuara dhe qëndrimet publike të mbajtura për to dhe nuk referohet aspak niveli i nevojshëm i ndërgjegjshëm për rëndësinë e detyrave dhe të përgjegjësive, si përfaqësues i organit më të lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;

Në analizë të temave dhe qëndrimeve të mbajtura publikisht nga anëtari i Këshillit Mbikëqyrës, (sa kohë ato nuk kanë lidhje me funksionin zyrtar të ushtruar sipas një akti emërimi nga Kuvendi), arrihet në dyshime të arsyeshme, që nga publiku i gjerë ato perceptohen si raste për të cilat zoti Malaj për qëndrimet e shprehura publikisht, të ketë kërkuar ose të ketë marrë udhëzime nga institucione apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga Banka e Shqipërisë (cilado qofshin ato);

Secila prej daljeve publike të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe të gjitha rastet së bashku çojnë në konkluzionin që temat e trajtuara dhe qëndrimet e shprehura mund të ndikim negativ mbi detyrimet që ai ka ndaj Bankës së Shqipërisë dhe sa kohë që ato shprehin qëndrime dhe vlerësime që janë pjesë e analizave politike të lidhura me forca, apo grupime politike, besojmë se kësaj dëmtojë edhe imazhin e Bankës së Shqipërisë;

Secila prej daljeve publike të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe të gjitha rastet së bashku çojnë në konkluzionin që temat e trajtuara dhe qëndrimet e shprehura bien ndesh dhe cenojnë pavarësinë dhe integritetin që kërkon pozicioni i mbajtur në Bankën e Shqipërisë, e për të cilin Zoti Arben Malaj është votuar nga Kuvendi i Shqipërisë;

Në interpretim të dispozitave Ligjore dhe rregullave etike, mund të konkludohet lehtësisht që e vetmja liri e lejuar për anëtarin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë është liria akademike. Në kodin e etikës edhe në këtë rast vendoset si kushti sqarimi që: *“Në artikujt shkencorë ose akademikë, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të qartësojnë se artikulli është hartuar personalisht dhe nuk përfaqëson qëndrimin zyrtar të Këshillit Mbikëqyrës apo të Bankës së Shqipërisë”*.

Daljet dhe prononcimet publike për tema plotësisht ose thellësisht politike, kanë qenë të vazhdueshme edhe gjatë periudhës zgjedhore për zgjedhjet lokale të datës 30 Qershor dhe në to ka haptazi deklarime të vullnetit personal për rikthimin në politiken aktive. Kujtojmë që edhe Kodi Zgjedhor e ndalon shprehimisht angazhimin publik të zyrtarëve shtetërorë gjatë periudhave zgjedhore.

Në përfundim të kësaj analize,

Me shumicën e votave të deputetëve prezent, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, vlerësoi se anëtari i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, Zoti Arben Malaj është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të mëtejshëm të funksionit, për shkak të veprimeve që bien ndesh me dispozitat e parashikuara nga neni 47/pika2/c/d e Ligjit Nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë, i ndryshuar”.

Ky Raport i përcillet seancës plenare për vendimmarrje të mëtejshme.

KRYETAR

ARBEN AHMETAJ